



ZYRA E PROKURIMIT

Nr 082/2021

Nr. Protokolli: 119/2021

Për:	Selman Elshani B.I NTSH Flamuri 1979 Suharekë dhe Avni R Elshani B.I NTSH AUTO KOSOVA PETROLL Suharekë,
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	11.08.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtim të derguar në Platforme Elektronike të datës 10.08.2021 , të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: Selman Elshani B.I NTSH Flamuri 1979 Suharekë dhe Avni R. Elshani B.I NTSH AUTO KOSOVA PETROLL Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në teritorin e Komunes se Suharekës** me Nr. të Prokurimi: 624-21-3919-2-2-1 & 624-21-87-221 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e datës 10.08.2021 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: Selman Elshani B.I NTSH Flamuri 1979 Suharekë dhe Avni R Elshani B.I NTSH AUTO KOSOVA PETROLL Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në teritorin e Komunes se Suharekës** Njoftim për Vendimin e te AK –së, të 05.08.2021 të publikuar në platformen elektronike.
2. *Vërtetohet* Njoftim për Vendimin e AK –së, të 05.08.2021.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 10.08.2021, ka pranuar dy kërkesa për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit **Shërbimet e zhvendosjes me marimangë dhe bllokimit të automjeteve në teritorin e Komunes se Suharekës** me Nr. të Prokurimi: 624-21-3919-2-2-1 & 624-21-87-221 ne lidhje me Njoftimin per Vendimin e AK –së, të 05.08.2021 të publikuar në platformen elektronike.

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se **Ju nuk jeni pale e interesit per kete aktivitet te prokurimit**, pasi qe kerkesat e juaja per ri-shqyrtim kane te bejne me vendimin e AK-se ne lidhje me vleresimin e ofertave. Vendim ky ne te cilin ju nuk jeni te perfshire pasi qe nuk jeni ofertues, andaj, kerkesat e juaja per ri-shqyrtim nuk jane konform akteve ligjore per prokurim publik, konkretisht **F03 Rregullat per parashtrim te ankesave te publikuara** ne ueb faqen e e-prokurimit si dhe **nenit 108/A te LPP-se**, i cili citon “Cdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues.”.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Afrim BYTYQI

